



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijshe/Prodato Received/Delivered	19-07	3	viti god year
Organ/Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHUK	5307/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.774/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.774/2023 të datës 24.05.2023 të parashtruar nga ankuesi nga kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike-administrative ‘kundërshtim i masës disiplinore’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi KD.nr.025/2023 i datës 16.05.2023, i Komisioni Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës si dhe Vendimi Nr.713 i datës 22.05.2023 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe **çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje** të Komisioni Disiplinor.

II. Obligohet Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore të ankuesit dhe të veproj në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje vetëm ankuesi) më datë 24.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.774/2023, kundër Vendimit KD.Nr.025/2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe Vendimit Nr.713 të datës 22.05.2023 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe pezullim të efektshmërisë së vendimit për transferim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës (me tej SHKK) ndërsa kjo e fundit më datë

06.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokoll 4982/2023 të datës 30.06.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 24.05.2023 me Nr.Prot:4400/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Inicimin e procedurës disiplinore me Nr.240 të datës 20.04.2023 nga Mbikëqyrës i lartë në QKM-Lipjan; Raportin Hetimor me Nr.453 të datës 13.04.2023 nga Komisioni Hetues i SHKK-së; Vendimin me numër KD.Nr.025/2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit Disiplinor në SHKK; Ftesën për intervistë ndaj ankuesit të datës 08.05.2023 nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me Nr/713 të datës 22.05.2023 nga zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së lidhur me transferin e ankuesit; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 30.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Procesverbalin e intervistës së datës 11.05.2023 për ankuesin; Procesverbalin e intervistës së datës 12.05.2023 për ankuesin; Fletëkthesën e datës 17.05.2023 lidhur me dërgimin e vendimit të Komisionit Disiplinor të ankuesit si dhe Vendimin me numër 4982/2023 të datës 30.06.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankuesit sipas ankesës me numër 774/2023 të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që ka nxjerr aktin administrativ të kontestuar, **sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe se i njëjti sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 30.06.2023 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Zyrtar Korrektues*, në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datën 16.05.2023 përmes Vendimit me numër KD.Nr.025/2023 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "*Transferim në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj*", me arsyetimin se ankuesi është përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore bazuar në nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1 dhe paragrafin 3.3 si dhe bazuar në nenin 25 paragrafin 2 dhe nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë si dhe nenin 58 paragrafin 3 nën paragrafët 3.4, 3.12, 3.20, dhe 3.24 të Ligjit 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa me datë 22.05.2023 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës me Vendimin me numër protokoll 713 të datës 22.05.2023 ankuesin e ka transferuar në Burgun e Sigurisë së Lartë për periudhën gjashtë (6) mujore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar ashtu që të anulohet dhe apo ndryshohet vendimi i Komisionit Disiplinor të SHKK-së me numër KD.nr.025/2023 i datës 11.05.2023 si dhe të pezullohet efektshmëria e vendimit të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së i datës 22.05.2023 deri në marrjen e vendimit nga Këshilli.

Bazuar në dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: *1. Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve...*" rrjedhë së nëpunësit e shërbimit korrektues


kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, duke nënkuptuar se themelimi, ndryshimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe legjislacionit të veçantë gjegjësisht me ligj të veçantë mund të rregullohen ndryshe vetëm elementet nga marrëdhënia e punës të përcaktuar me nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rrejdhimisht, referuar qëllimit të këtyre normave juridike rezulton së rregullimi me ligj të veçantë duhet të jetë në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe mund të rregullohen ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: **kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimi profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve.** Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor Kolegji konstaton se ndaj nëpunësit civil të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës mund të shqiptohen vetëm masat disiplinore të përcaktuara me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, e me te cilat dispozita është përcaktuar se: “1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”, sepse çështjet disiplinore nuk përbejnë element-fushë që mund të rregullohej ndryshe me ligj të veçantë.

Bazuar në konstatimin si me sipër, dhe duke qenë se me Vendimin KD.nr.025/2023 të datës 16.05.2023 të Komisioni Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankuesi është shpallur përgjegjës për shkelje të rendit disiplinore dhe së ndaj të njëjtit është shqiptuar masa disiplinore “Transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj” sipas nenit 59 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës gabimisht ka zbatuar dispozitat material lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit, kështu që një e metë e tillë ligjore ka bërë të pamundur shqyrtimin meritore të kësaj çështje juridiko-administrative, andaj në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil, Kolegji ka anuluar Vendimin KD.nr.025/2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit Disiplinor si dhe Vendimin Nr.713 të datës 22.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke kthyer çështjen në ri-shqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor, me detyrimin që i njëjti brenda afatit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit, të bëjë rishqyrtimin e kësaj çështje disiplinore dhe të vendos në pajtim me pikëpamjet juridike të Kolegjit si në arsyetimin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.774/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në SHKK;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve në SHKK dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.